

Drejtoria e Monitorimit

Misioni

Misioni i Drejtorisë së Monitorimit është të **përmirësojë cilësinë e jetës urbane** përmes analizës së vazhdueshme të performancës, mbikëqyrjes së shërbimeve publike, dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet administratës vendore, komunitetit dhe institucioneve partnere, në përputhje me parimet e qeverisjes së hapur dhe transparente.

Objektivat Kryesorë

- Rritja e **cilësisë dhe standardit të shërbimeve publike** në territorin e Bashkisë Elbasan.
- Zbatimi dhe monitorimi i kontratave të pastrimit, ndriçimit dhe mirëmbajtjes rrugore.
- Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i **të dhënave të hapura dhe treguesve të performancës**.
- Përmirësimi i mekanizmave të komunikimit me qytetarët dhe menaxhimi i ankesave në kohë.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për një **menaxhim të qëndrueshëm të territorit**.
- Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies përmes raporteve periodike të analizës dhe performancës.
- Zhvillimi i kapaciteteve të stafit për monitorim dhe raportim profesional të shërbimeve.

Sektoret përbërës të Drejtorisë së Monitorimit

1. Sektori i Hartimit të Analizave dhe Monitorimit të Shërbimeve Publike

- Mbikëqyr funksionimin e shërbimeve publike (rrugë, ndriçim, pastrim, kanalizime, ujësjellës).
- Harton analiza ditore, javore, mujore dhe vjetore për cilësinë e shërbimeve dhe mirëmbajtjes.
- Verifikon në terren problematikat e evidentuara dhe propozon zgjidhje për përmirësim.
- Koordinon me ndërmarrjet dhe operatorët ekonomikë për zbatimin korrekt të kontratave.
- Ndjek dhe zgjidh kërkesat e qytetarëve, duke siguruar përgjigje të argumentuara dhe në afat.

2. Sektori i Politikave Administrative


- Koordinon punën e **njësive administrative dhe lagjeve** me drejtoritë e bashkisë.
- Mbledh, përpunon dhe analizon informacionin e terrenit për nevojat e zhvillimit lokal.
- Siguron zbatimin e politikave të miratuara dhe ndjek harmonizimin e tyre me planifikimet strategjike.
- Monitoron planin e punës, realizimin e objektivave dhe raportimin periodik të çdo njësie administrative.

- Bashkëpunon me administratën vendore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe komunikimit me komunitetin.

3. Sektori i Analizës, Statistikave, Performancës dhe të Dhënave të Hapura

- Përgatit dhe publikon treguesit e performancës së Bashkisë Elbasan.
- Harton raportet statistikore, evidencat tremujore dhe raportin vjetor të performancës.
- Menaxhon **portalet e Open Data dhe Programin e Transparencës**.
- Zhvillon analiza mbi ecurinë e punës së drejtorive dhe ofron rekomandime për përmirësim.
- Bashkëpunon me institucionet qendrore, INSTAT-in dhe OGP-në për përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Organigrama e Drejtorisë së Monitorimit



Drejtoria e Monitorimit

Bashkia Elbasan, Rruga “Qemal Stafa”

Tel: 054 52797 | Email: bashkiaelbasan@yahoo.com